



## **KUSHTET E PËRGJITHSHME PËR HAPJEN DHE UDHËHEQJEN E LLOGARISË SË TRANSAKSIONIT PËR KRYERJEN E QARKULLIMIT PAGESOR NË VEND**

Komercijalna Banka AD Skopje (në tekstin e mëposhtëm: Banka), përcakton kushtet e përgjithshme për hapjen, udhëheqjen dhe mbylljen e llogarive të transaksionit të poseduesve të llogarive të transaksionit, bazën për llogaritjen e normës së interesit, kompensimin për kryerjen e shërbimeve të qarkullimit pagesor, njoftimin e poseduesve të llogarive të transaksionit, reklamacionet dhe vlefshmërinë e kushteve të përgjithshme. Përveç kryerjes së punëve të caktuara në qarkullimin pagesor në vend, kushtet e përgjithshme u dedikohen edhe të drejtave dhe përgjegjësisë të krijuara me marrëdhënien kontraktuese të Bankës dhe Poseduesit të llogarisë së transaksionit, si dhe të drejtave të personave të autorizuar, të cilët e përfaqësojnë Poseduesin e llogarisë.

### **1. Dispozitat e përgjithshme**

1.1. Marrëdhënia juridike midis Bankës dhe Poseduesit të llogarisë së transaksionit lind me nënshkrimin e Marrëveshjes për hapjen dhe udhëheqjen e llogarisë së transaksionit për kryerjen e qarkullimit pagesor në vend. Përmes Marrëveshjes, Poseduesit të llogarisë së transaksionit Banka i jep një kopje të kushteve.

Kushtet e përgjithshme për hapjen, udhëheqjen dhe mbylljen e llogarisë së transaksionit janë pjesë përbërëse të Marrëveshjes për hapjen dhe udhëheqjen e llogarisë për kryerjen e qarkullimit pagesor në vend.

1.2. Për të gjitha ndryshimet, që Banka do t'i kryejë në kushtet e përgjithshme për hapjen, udhëheqjen dhe mbylljen e llogarisë së transaksionit, në mënyrë adekuate i njofton poseduesit e llogarisë së transaksionit.

### **2. Hapja e llogarisë së transaksionit**

2.1. Poseduesit të llogarisë, Banka hap llogarinë e transaksionit nëse i plotëson kërkesat dhe kushtet në vazhdim:

- Të dorëzojë kërkesë për hapjen e llogarisë së transaksionit në formular të brendshëm të Bankës, dhe
- Të dorëzojë dokumentacionin, i cili mundëson identifikimin e Poseduesit të llogarisë, të personave të autorizuar për të disponuar me mjetet e llogarisë së transaksionit, të personave të autorizuar për marrjen e raporteve, dorëzimin e urdhërpagesave dhe/ose personave të autorizuar për tërheqjen e parave të gatshme nga llogaria e transaksionit.

Banka, më së voni në afat prej 2 ditësh pune nga pranimi i kërkesës së plotësuar për hapjen e llogarisë së transaksionit dhe dokumentacionit përcjellës, lidhë marrëveshje dhe hap llogarinë. Banka mund ta refuzojë marrëveshjen në mënyrë të njëanshme nëse vërteton se Poseduesi i llogarisë së transaksionit është sjell në kundërshtim të

dispozitive të këtyre kushteve ose rregullave në fuqi dhe për këtë menjëherë ta njoftojë dorëzuesin e kërkesës.

Me nënshkrimin e Marrëveshjes, Poseduesit të llogarisë së transaksionit Banka i jep kartë për llogarinë e transaksionit për persona juridik, kurse për të gjitha personat të cilët janë të autorizuar për marrjen e raporteve, dorëzimin e urdhërpagesave dhe/ose janë të autorizuar për tërheqjen e parave të gatshme nga llogaria, banka u jep kartela identifikimi, secilit në veçanti, me numër të veçantë të ID-së (numër sistematik serik i gjeneruar dhe lidhur me numrin amë të personit)

Me qëllim mbrojtjen e interesave, Poseduesi i llogarisë dhe personat të cilët posedojnë kartelë identifikimi janë të detyruar të mbajnë llogari për mënyrën e shfrytëzimit dhe ruajtjes së saj, ashtu që ID numri mos të jetë pa nevojë i dukshëm dhe i kapshëm për persona të paautorizuar.

Banka nuk mban përgjegjësi nëse vjen deri te keqpërdorimi i kartelës ose ID numrit.

Poseduesi i llogarisë së transaksionit është i detyruar ta njoftojë Bankën, nëse ndonjëra nga kartelat janë të humbura.

Secili person që ka marrë kartelës për identifikim me ID numër të veçantë është personalisht përgjegjës për të dhe është i detyruar ta njoftojë Bankën për humbjen eventuale ose vjedhjen e kartelës.

Në këtë rast Banka do t'i jep kartele të re me numër të ri identifikimi.

### **3. Udhëheqja e llogarisë së transaksionit**

3.1. Të gjitha do kumentet, të dhënat dhe informacionet, të cilat janë fituar gjatë hapjes dhe udhëheqjes së llogarisë së transaksionit për kryerjen e qarkullimit pagesor në vend paraqesin fshehtësi bankare, të cilën Banka është e detyruar ta mbrojë dhe ruaj, përveç në rastet kur të dhënat dhe informacionet u jepen personave të tretë në bazë të rregullave ligjore. Banka obligohet t'i ruaj në fshehtësi të gjitha të dhënat deri të cilët do të vijë gjatë punës me Poseduesin e llogarisë së transaksionit. Të dhënat që kanë trajtim të fshehtësisë bankare Banka mund pajtim të Poseduesit të llogarisë t'ua dorëzojë vetëm personave të autorizuar në pajtim me rregullat ligjore.

Në përputhje me rregullat ligjore mbrojtjen e të dhënave personale, Banka ka detyrim të mbrojë të dhënat personale për përfaqësuesin ligjor të Poseduesit të llogarisë, personat e autorizuar për disponim me mjetet nga llogaria dhe themeluesit-persona fizikë dhe persona të tjerë për të cilët Banka ka të dhëna.

3.2. Poseduesi i llogarisë së transaksionit i lejon Bankës në çdo kohë t'i marr të dhënat, të cilat kanë të bëjnë me udhëheqjen e llogarisë së transaksionit dhe janë të shënuara në kërkesën për hapjen e llogarisë.

3.3. Banka obligohet se Poseduesi i llogarisë së transaksionit, nëpërmjet llogarisë së tij të transaksionit do të pranojë, paguajë dhe do të realizojë pagesa në kuadër të saldosit të llogarisë, në pajtim me marrëveshjen që do ta lidhë me Poseduesin e llogarisë së transaksionit, osë në bazë të vendimit të Bankës.

3.4. Gjendja pozitive e llogarisë së transaksionit paraqet depozitë në denarë në të parë me të cilën Poseduesi i llogarisë së transaksionit lirisht do të disponojë.

3.5. Me mjetet e llogarisë së transaksionit disponon Poseduesi i llogarisë së transaksionit.

3.6. Poseduesi i llogarisë së transaksionit mund të autorizojë persona të tretë të disponojnë me mjetet e llogarisë së transaksionit. Ky autorizim nuk mund të transferohet personave të tretë dhe nuk ka të bëjë me të drejtën e mbylljes së llogarisë së transaksionit.

3.7. Personat, të cilët janë të autorizuar të disponojnë me mjetet e llogarisë së transaksionit, janë të detyruar të deponojnë nënshkrimin në Bankë. Nënshkrimet e deponuara në Bankë, vlejnë deri në momentin e tërheqjes nga Poseduesi i llogarisë së transaksionit, pavarësisht nga regjistrimi i ndryshimit të regjistruar ose shpalljes në gaztën zyrtare. Banka nuk mban përgjegjësi për dëmet eventuale që mund të ndodhin për Poseduesin e llogarisë së transaksionit për shkak të mosnjohimit në kohë të ndryshimit të personave të autorizuar.

3.8. Poseduesi i llogarisë së transaksionit duhet të caktojë persona, të cilët do të jenë të autorizuar për marrjen e raporteve, dorëzimin e urdhërpagesave dhe/ose tërheqjen e parave të gatshme nga llogaria e tij. Personat, të cilët do të jenë të autorizuar për tërheqjen e parave të gatshme nga llogaria e transaksionit të Poseduesit të llogarisë, janë të detyruar ta deponojnë nënshkrimin në Bankë

Autorizimi dhe nënshkrimet e deponuara në Bankë të këtyre personave, vlejnë deri në momentin e tërheqjes nga poseduesi i transaksionit. Banka nuk merr përgjegjësi për dëmet eventuale që mund të ndodhin për Poseduesin e llogarisë së transaksionit për shkak të mosnjohimit në kohë të ndryshimeve të personave të autorizuar për marrjen e raportit, për dorëzimin e urdhërpagesave dhe/ose tërheqjen e parave të gatshme.

#### **4. Ekzekutimi i instrumenteve pagesore**

4.1. Instrumentet pagesore, që Poseduesi i llogarisë së transaksionit i dorëzon në bankë, domosdoshmërisht duhet të plotësohen sipas standardeve të qarkullimit pagesor. Ata mund të derogohen në letër ose në formë elektronike, së bashku me dokumentacionin e përshkruar.

Instrumentet pagesore mund të dorëzohen edhe në formatin MT 101, sipas rregullave pagesore (instruksione për pagesë) të pranuar nëpërmjet sistemit SVIFT, në bazë të autorizimit të posaçëm të dhënë për pranimin e instrumenteve pagesore në formatin MT101 nëpërmjet sistemit SVIFT, nga ana e personit të autorizuar që përfaqëson poseduesin e llogarisë.

4.2. Instrumenti pagesor mund të ketë valutë për ekzekutim të njëjtën ditë, ose valutë për ekzekutim në një ditë tjetër në të ardhmen. Instrumentet pagesore, të cilat kanë valutë për ekzekutim në ditën e dorëzimit, ekzekutohen po atë ditë, me kusht që të jenë të dorëzuara në pajtim me orarin e Bankës për punë me qarkullimin pagesor, por nëse është dorëzuar më vonë, atëherë do të ekzekutohet ditën e ardhshme të punës, nëse për të njëjtin kambulesë nga llogaria e transaksionit.

4.3. Poseduesi i llogarisë së transaksionit është përgjegjës për saktësinë dhe kompletimin e të dhënave të instrumentit pagesor. Banka nuk do të pranohet instrumentet pagesore më datë të vjetër të ekzekutimit, të plotësuara në mënyrë jo të plotë dhe gabimisht.

4.4. Poseduesi i llogarisë së transaksionit dhe Banka mund të merren vesh që Poseduesi i llogarisë së transaksionit të caktojë prioritetin për ekzekutimin e

instrumenteve pagesore, në të kundërtën Banka do t'i realizojë instrumentet sipas kohës së pranimit, por duke i respektuar prioritetet ligjore.

4.5. Përmbajtja e instrumenteve pagesore që dorëzon Poseduesi i llogarisë së transaksionit, duhet të jetë e qartë, e lexueshme dhe e saktë. Banka nuk mban përgjegjësi për dëmin që do të ndodhë për shkak të vonesës së ekzekutimit të instrumentit pagesor, me kusht që kjo vonesë të jetë e shkaktuar për shkak të verifikimit plotësues të të dhënave. Kjo, posaçërisht ka të bëjë me transferimet e parave per sonave të tretë, kur Poseduesi i llogarisë duhet saktë ta përcaktojë pranuesin e mjeteve, numrin e llogarisë së transaksionit dhe të dhënat tjera të nevojshme për Bankën, nëpërmjet të cilës realizohet pagesa. Poseduesi i llogarisë së transaksionit mban përgjegjësi për pasojat e plotësimit me gabim të instrumenteve pagesore.

4.6 Përmbajtja e porosisë pagesore MT101 (instruksione për pagesën), e pranuar nëpërmjet sistemit SVIFT, duhet të jetë e qartë, precize dhe t'i përmbajë të gjitha elementet e duhura në bazë të të cilave duhet të realizohet pagesa. Kjo, posaçërisht ka të bëjë me transferet e parave për personat e tretë, kur saktë duhet të përcaktohet pranuesi i mjeteve, numri i llogarisë së transaksionit dhe nevojat tjera për realizimin e pagesës. Poseduesi i llogarisë mban përgjegjësi për pasojat për shkak të dorëzimit të të dhënave të gabueshme ose të dhënave jo të plota për realizimin e pagesës. Banka nuk mban përgjegjësi e as ka ndonjë detyrim për verifikimin e vlefshmërisë dhe autëoritetit të porosisë pagesore MT101 nëpërmjet sistemit SVIFT, ose verifikimin e nëns hkruesve të autorizuar të porosisë. Përgjegjësia kryesore për instruksionet e këtyllave pagesore të pranuaras bi e mbi Poseduesin e llogarisë së transaksionit.

4.7. Nëse gjatë realizimit të pagesës vjen deri të ndonjë lëshim eventual nga Banka, shpenzimet e shkaktuara banka do t'ia kompensojë Poseduesit të llogarisë.

4.8. Poseduesi i llogarisë së transaksionit mund të realizojë pagesa në dobi të poseduesve të transaksioneve në banka të tjera afariste (pagesa, të cilat në pajtim me Vendimin e BPRM për përcaktimin e shumës në pakicë të pagesave ndërmjet bankave, të cilat nuk konsiderohen si pagesa të mëdha), nëpërmjet sistemit të Shtëpisë së Kliringut, ku pagesat quhen të përfunduara pas realizimit të barazimit të llogarive të transaksionit të bankave në sistemin e BPRM dhe nëpërmjet sistemit për barazim të BPRM t.a. q. MIPS (pagesa, të cilat sipas Vendimit të BPRM për përcaktimin e shumës së vogël të pagesave ndërmjet bankave konsiderohen pagesa të mëdha dhe pagesa që janë urgjente). Zgjedhjen e mënyrës së realizimit të pagesës, Poseduesi i llogarisë së transaksionit e bën me emërtimin e instrumenteve pagesore. Nëse Poseduesi i llogarisë së transaksionit nuk e përcakton mënyrën e realizimit të instrumenteve pagesore, Banka sipas zgjedhjes së saj dhe në mënyrën më të mirë të mundshme do ta realizojë pagesën.

## **5. Shërbime plotësuese**

5.1. Poseduesit të llogarisë së transaksionit, Banka i mundëson shërbime plotësuese të lidhura me llogarinë dhe për këtë gjë Banka dhe Poseduesi i llogarisë së transaksionit merren vesh për lidhjen e një marrëveshjeje të posaçme. Banka mund të miratojë kushte të posaçme për realizimin e shërbimeve plotësuese.

## **6. Njoftimi**

Konsiderohet se Poseduesi i llogarisë së transaksionit e pranon raportin nëse të njëjtin nuk e konteston në afat prej 8 (tetë) ditëve nga dita e pranimit.

6.1. Poseduesi i llogarisë së transaksionit, në pajtim me rregullat ligjore është i detyruar ta njoftojë Bankën për të gjitha ndryshimet në lidhje me statusin juridik, ndryshimin e të dhënave personale dhe të dhënave të tjera të personave të autorizuar dhe të dhënave të tjera që kanë të bëjnë me hapjen e llogarisë së transaksionit dhe janë të shënuara në kërkesën për hapjen e llogarisë së transaksionit. Banka nuk merr përgjegjësi për shkak të mosrespektimit të detyrimeve për realizimin e ndryshimeve.

6.2. Për gjendjen dhe ndryshimet e ndodhura në llogarinë e transaksionit, Banka obligohet ta njoftojë Poseduesin e llogarisë së transaksionit me dorëzimin e Raportit të ndryshimeve dhe gjendjen e llogarisë së transaksionit, në mënyrën e përcaktuar në marrëveshje nga Poseduesi i llogarisë së transaksionit.

6.3. Konsiderohet se Poseduesi i llogarisë së transaksionit e pranon raportin nëse të njëjtin nuk e konteston në afat prej 8 (tetë) ditëve nga dita e pranimit.

## **7. Llogaritja e interesit, provizionit dhe shpenzimet**

7.1. Poseduesit të llogarisë së transaksionit, Banka i miraton dhe paguezuar për interesin për mjetet e llogarisë së transaksionit për afatin, mënyrën, shkallën e interesit, të cilat janë përcaktuar me Vendimin e bankës për shkallën e interesit. Banka normat e interesit të llogaritura i shënon në fund të periudhës parallogaritëse ose me mbylljen e llogarisë së transaksionit.

7.2. Poseduesit të llogarisë së transaksionit Banka i llogaritë normë interesi dhe i paguan kompensim për realizimin e punëve në qarkullimin pagesor, në pajtim me Tarifatat e Bankës. Këto kërkesa, Banka i shkruan në interesin e saj dhe në ngarkesë të llogarisë së transaksionit të Poseduesit të saj dhe për këtë e njofton nëpërmjet raportit.

## **8. Mbyllja e llogarisë**

8.1. Poseduesi i llogarisë së transaksionit në pajtim me Bankën mund në çdo kohë me shkrim të kërkojë prishjen e Marrëveshjes për hapjen dhe udhëheqjen e llogarisë së transaksionit për realizimin e qarkullimit pagesor. Poseduesi i llogarisë së transaksionit mund, në mënyrë të njëanshme, ta prishë marrëveshjen me afat anulimi prej 30 ditëve. Në të dyja rastet, Poseduesi i llogarisë së transaksionit është i detyruar në tërësi t'i kryejë të gjitha detyrimet e marrëveshjes, të ndodhura deri në ditën e prishjes së saj.

8.2. Poseduesi i llogarisë së transaksionit duhet me shkrim ta njoftojë Bankën për të gjitha ndryshimet, të cilat mund të ndikojnë në vlefshmërinë e marrëveshjes. Nëse nuk e bënë këtë, Banka mund ta prishë Marrëveshjen. Të gjitha pasojat financiare të ndodhura për shkak të mosnjoftimit në kohë, do të jenë në ngarkesë të Poseduesit të llogarisë.

8.3. Banka mund, me shkrim, ta prishë Marrëveshjen, nëse Poseduesi i llogarisë ka punuar në kundërshtim me dispozitat e këtyre kushteve të përgjithshme, marrëveshjes ose rregullave ligjore.

8.4. Marrëveshja pushon të vlejë nës e në 2 (dy) v itet e f undit, në l logarinë e transaksionit të Poseduesit, nuk ka patur mjete dhe q arkullim, s i dhe në baz ë t ë vendimeve të organit përgjegjës në pajtim me rregullat ligjore.

8.5. Marrëveshja pushon të vlejë në di tën e m bylljes së l logarisë së transaksionit. Poseduesi i llogarisë së transaksionit është i detyruar ta kthejë kartën e i dentifikimit tek B anka. Nëse k arta e i dentifikimit nuk kthehet, B anka nuk merr përgjegjësi për keqpërdorimin eventual të saj.